



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM
Nr. 519, datë 03.11.2021

PËR
PËRJASHTIMIN E GJYQTARES KLEJDA ÇAPJA NGA LISTA E GJYQTARËVE QË
CAKTOHEN PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË VEÇANTA NË
GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTRON FUNKSIONIN NË
MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 170/1 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 97 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në paragrafin VIII, pika 6, të Vendimit nr. 30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, pasi shqyrtoi kërkesën dhe materialet bashkëlidhur asaj, paraqitur nga gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, znj. Klejda Çapja,

VENDOSI:

1. Përfshirjen e gjyqtares znj. Klejda Çapja, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, nga lista e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, për një afat 6 (gjashtë) mujor.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR